



RAPORT VJETOR

1 Korrik 2016 - 30 Qershor 2017

Dorëzuar në Tetor 2017



Përmbajtja

I. Informacion bazë.....	4
II. Përmbledhje.....	5
III. Kapitulli 2: Rezultatet e arritura gjatë periudhës 2016 - 2017 (Viti 2).....	6
IV. Kapitulli 3: Modalitetet e Zbatimit.....	17
Monitorimi dhe vlerësimi.....	17
Perspektiva gjinore.....	17
Qasja ndaj komunikimit.....	18
V. Kapitulli 4: Financat dhe menaxhimi.....	19
VI. Kapitulli 5: Vazhdimësia.....	20

Shkurtesat

BK	Bordi Këshillimor
NjA	Njësi Administrative
OSHC	Organizata të Shoqërisë Civile
GMS	Sistemi i Menaxhimit të Granteve
PPGj	Politika e Perspektivës Gjinore
BG	Bordi i Granteve
LA	LevizAlbania
OSFA	Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë
IMS	Instrumenti Mundësues Strategjik
PVO	Plani Vjetor Operacional

I. Informacion bazë

Vendi: Shqipëri	Emri i projektit: LevizAlbania
Qëllimi	Qytetarët shqiptarë përfitojnë nga përmirësimi i demokracisë në nivel vendor
Rezultatet (Objektivat e Projektit, Synimi)	Rezultati 1: Aktorët e shoqërisë civile ndikojnë në përcaktimin e përparësive, në vendimmarrje dhe në mbikëqyrjen e autoriteteve vendore Rezultati 2: Aktorët e shoqërisë civile ndërmarrin dhe mbështesin ndryshime strukturore për të përmirësuar demokracinë në nivel vendor
Kohëzgjatja e fazës së projektit: 1 Korrik 2015 - 30 Qershor 2019	Periudha e raportimit: 1 Korrik 2016 - 30 Qershor 2017
Buxheti në dispozicion:	1,861,920 CHF
Informacion për kontributet e partnerëve dhe/ose donatorëve të tjerë (llogaritur në CHF): N/A	
Organizatat zbatuese:	OSFA, Co-PLAN, Partnerët Shqipëri
Partneri kryesor vendas: Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (OSFA)	Partnerët kryesorë ndërkombëtarë: N/A
Drejtues Ekipi: Valbona Kuko	Numri i personelit të projektit: 10
Raporti i është dorëzuar Ambasadës Zvicerane në Tiranë, më 18 Tetor 2017	

II. Përmbledhje

LevizAlbania (LA) vepron në një fushë me shumë projekte dhe nisma qeveritare që mbështesin reformën e qeverisjes vendore me fokus forcimin e decentralizimit financiar, përmirësimin e cilësisë së shërbimeve publike, rritjen e transparencës dhe llogaridhënies së autoriteteve vendore dhe forcimin e pjesëmarrjes së komunitetit në proceset e vendimmarrjes.

Ndërsa shumica e projekteve të tjera përqëndrohen në forcimin e kapaciteteve të qeverisjes vendore, LA fokusohet veçanërisht në forcimin e aktorëve të shoqërisë civile për të ndikuar në mënyrë të tërthortë në demokracinë vendore. Me këtë cilësi të dallueshme, LA krijoi dhe konsolidoi profilin e saj dhe aktualisht konsiderohet projekt pararojë për shoqërinë civile, që po frymëzon donatorë të tjerë të strukturojnë ndërhyrje të ngjashme sipas modelit të LA.

LA dallohet për qasjen novatore, procedurat transparente, lehtësinë e aplikimit dhe mbështetjen për OSHC-të e vogla dhe ende të pakonsoliduara me bazë në komunitet, si edhe për individët. Me objektivin për të adresuar shqetësimet lokale dhe për të përmirësuar demokracinë vendore, LA ka mbështetur gjithsej 78 ide përmes granteve për organizata (52), individë (22) dhe instrumentit të Reagimit të Shpejtë (4) në 43 bashki (70% të vendit) që mbulojnë një larmi çështjesh dhe problematikash.

Idetë fituese përfaqësojnë një kombinim të ideve më të rëndësishme relevante për të gjithë vendin, bazuar në interesa dhe shqetësime të qenësishme të komuniteteve lokale, nga rritja e pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrjen vendore, deri në forcimin e pjesëmarrjes së rinisë; nga advokimi për rritjen e transparencës, deri në monitorimin e premtimeve zgjedhore në lidhje me kërkesat dhe ndërhyrjet që lidhen me mjedisin. Deri më tani janë pranuar 661 aplikime, ndërsa 219 aplikantë kanë paraqitur idetë e tyre para Bordit të Granteve në tre thirrjet për aplikime të shpallura deri tani. Efektet e projekteve janë të prekshme në terren dhe vlerësohen nga komunitetet lokale.

Grantet kanë kontribuar në forcimin e rolit të qytetarëve për të kërkuar dhe rritur transparencën dhe llogaridhënien e qeverisjes vendore në përputhje me programin e transparencës dhe Ligjin për të Drejtën e Informimit, krijimin e mekanizmave funksionalë pjesëmarrës, në përmirësimin e shërbimeve publike për komunitetet, në përfshirjen sociale të grupeve të cënueshme si romët, egjiptianët dhe gratë (rurale), në rritjen e vullnetarizmit dhe aktivizmit të të rinjve, si edhe në nxitjen e debateve publike dhe protestave për çështjet me interes për publikun e gjerë.

Në dy thirrjet e ardhshme për aplikime, LA do t'i japë prioritet të qartë organizatave lokale dhe individëve, duke eksploruar fushat e shoqërisë civile që nuk kanë qenë shumë aktive deri tani. Fondet do të jenë të disponueshme kryesisht për organizatat e vogla dhe individët, ndërkohë që organizatat e konsoliduara do të jenë të detyruara të hyjnë në partneritet me organizatat lokale për të siguruar transferimin e njohurive dhe aftësive. Për këtë qëllim, do të krijohen dy fonde për grantet: një me limit 20,000 CHF për organizatat të vogla dhe tjetri me limit 50,000 CHF për organizatat e mëdha. Për thirrjen e radhës për aplikime, do të aplikohet procedurë *online* aplikimi për koncept-idetë, me qëllim zvogëlimin e barrës administrative për grantmarrësit dhe afatit për të gjithë procesin.

Gjithashtu, në këtë fazë të dytë të zbatimit të projektit, fokusi i LA do të zhvendoset drejt aktiviteteve të vijueshmërisë dhe ideve të zbatuara me sukses. Një nga drejtimet e Thirrjes nr. 4 për Aplikime i kushtohet projekteve të vijueshmërisë që synojnë të konsolidojnë më tej rezultatet e arritura nga grantet e mbështetura. Kjo do të shërbejë për të përmirësuar qëndrueshmërinë e ndërhyrjeve në zonat lokale dhe do të nxisë formimin e rrjeteve dhe partneriteteve mes organizatave dhe individëve. Për këtë drejtim të vijueshmërisë do të aplikohen procedura të thjeshtësuara.

Zbatimi i granteve plotësohet nga zbatimi i Instrumenteve Mundësues Strategjikë (IMS). Të dy projektet IMS që po zbatohen aktualisht kanë kontribuar në krijimin e mjeteve dhe rritjen e kapaciteteve për aktorët lokalë për të bashkëvepruar me autoritetet vendore. Platforma www.financat.e.al është bërë një mjet referimi për të gjithë aktorët dhe grupet e interesuara, me pothuajse 37,000 vizitorë në faqe. Platforma përmban të dhënat financiare të bashkive, në një formë të tillë që të kuptohen dhe të përdoren lehtë nga publiku.

Gjatë vitit të kaluar, puna me Platformën Financiare Vendore është fokusuar në tre fronte kryesore:

1. *Arkitektura e re e platformës që synon të rrisë përdorimin e kollajtë për përdoruesin - Versioni i ri i platformës* është projektuar me qëllimin kryesor që të përmirësojë përvojën e përdoruesve duke rritur numrin e analizave dhe vizualizimeve.
2. *Kalimi nga të dhënat te informacioni* - Gjatë vitit të kaluar, platforma e ka rritur përpunimin e të dhënave dhe frekuencën e publikimit nga baza vjetore, në 3-mujore. Ekipi punon për hartimin e raporteve 3-mujore dhe vjetore, që ofrojnë një përmbledhje konçize të tendencave dhe modeleve kryesore që vihen re gjatë periudhës 3-mujore ose 1-vjeçare, duke kaluar nga "të dhënat" në "informacion të vlefshëm dhe të përdorshëm".
3. *Promovimi i platformës si burim i besueshëm të dhënash për mediat, studiuesit, vetë bashkitë studentët, organizatat etj.*

Projekti tjetër IMS synon të forcojë OSHC-të për përfshirje dhe pjesëmarrje efektive në hartimin e politikave dhe në vendimmarrje. Në këtë kuadër, është krijuar një ndërfaqe trajnimi *online* dhe 196 pjesëmarrës kanë përfituar nga 21 aktivitetet për forcim kapacitetesh. Temat e trajnimeve përfshinin mobilizimin e komunitetit, shkrimin e projekt-propozimeve dhe qeverisjen me pjesëmarrje. Gjithashtu, janë organizuar tre sesione tematike për formim rrjetesh, ku morën pjesë 32 pjesëmarrës nga grantmarrësit e LA. Për të përmirësuar shkëmbimin e njohurive, projekti lehtësoi dy sesione rajonale për formim rrjetesh, me përfaqësues nga Kroacia dhe Kosova. Risi për ndërhyrjet ishte edhe organizimi nga projekti i 8 sesioneve këshilluese me grantmarrësit e LA dhe 8 organizata të tjera.

Nga Shtatori 2017, partneri i konsorciumit OSFA do të fillojë zbatimin e dy projekteve IMS: (i) ngritja e dy qendrave ligjore vendore në dy bashki dhe (ii) fuqizimi i mediave vendore - platforma multifunksionale për të mbështetur demokracinë vendore. Përdorimi i IMS rezultoi shumë i dobishëm për OSHC-të, sepse krijoi mjete dhe mekanizma që OSHC-të t'i përdorin në aksionet e tyre për përmirësimin e demokracisë vendore.

LA ka arritur një shtrirje të gjerë kombëtare, falë diversifikimit të kanaleve të komunikimit. LA mundësoi prodhimin e dy mini dokumentarëve dhe krijoi një fushatë mediatike agresive në median sociale dhe me pjesëmarrje në programe televizive për të promovuar LA, thirrjet për aplikime dhe Javën e Demokracisë Vendore të LA. Të gjithë grantmarrësit kanë qenë të pranishëm në rrjetet sociale dhe mediat lokale për të bërë publike aktivitetet e tyre dhe për të shumëfishuar ndërgjegjësimin e komunitetit.

Kapitulli 2: Rezultatet e arritura gjatë periudhës 1 Korrik 2016 - 30 Qershor 2017

LevizAlbania synon të arrijë dy Rezultate kryesore:

Rezultati 1: Aktorët e shoqërisë civile ndikojnë në përcaktimin e përparësive, në vendimmarrje dhe në mbikëqyrjen e autoriteteve vendore.

Rezultati 2: Aktorët e shoqërisë civile ndërmarrin dhe mbështesin ndryshime strukturore për të përmirësuar demokracinë në nivel vendor.

Grantet për organizatat dhe individët kanë ndikuar në qëllimin e përgjithshëm të projektit. LA ka mbështetur projekte me masa që influencojnë prioritetet dhe shërbimet publike vendore, vendimmarrjen dhe mbikëqyrjen e autoriteteve vendore në 43 bashki, ose 70.5% të qeverisjes vendore. Prej këtyre, 14 grante të mbështetura nga LA kanë monitoruar dhe kanë publikuar raporte me informacion dhe praktika që mund të përdoren nga publiku i gjerë. Sipas raportimeve, aksesin në informacion është përmirësuar në 18 bashki, nga 27 që kanë përfituar nga zbatimi i projekteve në këtë fushë. Progresi mesatar i raportuar në lidhje me aksesin në informacion në këto bashki është 4.5%¹, bazuar në metodologjinë që përdor BIRN.

¹ "Raport kombëtar monitorimi :Pushteti vendor nën lenden e të drejtës për informim" BIRN, Prill 2017.

Në 19 bashki, projektet e mbështetura nga LA kanë përmirësuar mekanizmat e pjesëmarrjes. Nëntë projekte kanë rritur pjesëmarrjen e rinisë në procesin vendimmarrës përmes: (i) *ngritjes së Bordeve Rinore Këshillimore, me qëllim që të llobojnë dhe të advokojnë për prioritetet e rinisë dhe të monitorojnë punën e Këshillave Bashkiakë, si dhe* (ii) *mbështetjes së aktivizmit dhe vullnetarizmit të të rinjve.*

Dy projekte kanë prezantuar modele të mira për llogaridhënien e të zgjedhurve dhe të emëruarve vendorë përkundër premtimeve që kanë bërë gjatë fushatës zgjedhore, gjë që ka sjellë mjaft progres në trajtimin e premtimeve zgjedhore në një bashki dhe 4 Njësi Administrative (NjA). Gjashtë projekte kanë rritur llogaridhënien e *pushtetit vendor për përmirësimin e praktikave të punës dhe shërbimit*, përmes kërkimit shkencor, monitorimit dhe TIK-ut, duke evidentuar (i) mangësitë në procedurat e dokumentimit dhe proceset e buxhetimit me pjesëmarrje në një bashki; (ii) mosrespektimin e kërkesave ligjore për miratimin e lejeve për hidrocentralet në luginën e Valbonës dhe lumin Vjosa; (iii) boshllëqet në ofrimin e shërbimeve publike të menaxhimit të integruar të mbetjeve, transportit publik, shërbimeve sociale dhe informimit publik në pesë bashki.

Pesë projekte kanë përdorur qasje dhe mjete novatore për të rritur kërkesën për transparencë dhe pjesëmarrjen publike përmes artikujve (tre projekte), multimedias dhe përdorimit të teknologjisë (katër projekte), ndërsa shumica e projekteve kanë përdorur mediat tradicionale dhe median sociale për të filluar dhe mbështetur debatet publike dhe protestat lidhur me ligjin për importin e mbetjeve, i cili nuk u dekretua nga Presidenti, si dhe nënshkrimin e peticionit për anulimin e ndërtimit të hidrocentraleve mbi lumin Vjosa. Projektet e mbështetura nga LA kanë realizuar 15 peticione nga komunitetet vendore si mjet presioni për trajtimin e prioriteteve të tyre.

Falë veprimeve të grantmarrësit Eco Albania, gjykata mori vendim në favor të kauzës: e drejta e qytetarëve për t'u dëgjuar në një proces konsultimi kuptimplotë për ndërtimin e hidrocentraleve. Një tjetër projekt prezantoi për herë të parë strukturimin e komunitetit bazuar në modelin e vetë-organizimit. Kjo qasje u përqaftua nga Bashkia e Beratit, e cila formalizoi këtë strukturë në zonën urbane.

Së paku 19 partneritete të OSHC-ve të mbështetura nga grantet e LA: (i) kanë kërkuar reformim të qeverisjes vendore dhe (ii) monitorojnë zbatimin e planeve dhe reformave të qeverisjes vendore. Disa shembuj janë: monitorimi i shërbimit zjarrfikës, kujdesi shëndetësor parësor, buxhetimi me pjesëmarrje, koncesionet publike, financat publike, menaxhimi i mbetjeve urbane, pjesëmarrja e të rinjve në procesin e vendimmarrjes etj.

Paralelisht, projekti prodhoi disa mjete dhe realizoi forcim kapacitetesh për OSCH-të vendore në mbështetje të aktiviteteve të tyre për përmirësimin e demokracisë në nivel vendor. Përmes njërit nga projektet IMS, LA krijoi platformën www.financatvendore.al që ofron informacion të gjerë mbi përdorimin dhe planifikimin e fondeve publike në çdo bashki, duke bërë të mundur që OSCH-të të marrin pjesë aktivisht në proceset e vendimmarrjes dhe llogaridhënies. Ky portal ka 36,859 vizitorë deri tani.

Në kuadrin e projektit tjetër IMS, aktorët lokalë janë trajnuar mbi tema të ndryshme që lidhen me qeverisjen vendore dhe pjesëmarrjen e qytetarëve, duke përdorur mjete *online* dhe trajnimet në formë klase. Ndërhyrje në shkallë të gjerë pritet të realizohen nga dy projektet e reja IMS, zbatimi i të cilave do të fillojë nga vjeshta e 2017-ës. Në vijim të bashkëpunimit intensiv me LA dhe orientimeve të saj, të gjithë grantmarrësit si organizata apo individë e kanë përdorur shpesh median sociale dhe kanalet e tjera kombëtare dhe lokale për të ekspozuar aktivitetet e tyre dhe për të promovuar idetë në komunitetet e tyre. Disa artikuj të publikuar nga grantmarrësit janë ri-publikuar në media të tjera, duke shumëfishuar kështu audiencën dhe efektin.

Rezultati 1: Aktorët e shoqërisë civile ndikojnë në përcaktimin e përparësive, në vendimmarrje dhe në mbikëqyrjen e autoriteteve vendore.

Bazuar në gjetjet e raportit të vlerësimit të jashtëm për projektet e financuara nga LA nën Thirrjen nr. 1 dhe nr. 2 për Aplikime, vlerësohet se projekti LA po bën progres dhe është në rrugën e duhur në arritjen e objektivit të përgjithshëm për të përmirësuar demokracinë në nivel vendor, përmes rezultateve të arritura nga grantet e zbatuara nën “*Rezultatit 1: Aktorët e shoqërisë civile ndikojnë në përcaktimin e përparësive, në vendimmarrje dhe në mbikëqyrjen e autoriteteve vendore*”.

Projekti ka prodhuar ndryshime konkrete në jetën e komuniteteve, përmes presionit nga poshtë lart dhe i ka bërë aktorë të ndryshimit në jetën e tyre duke shfrytëzuar edhe larminë e produkteve të djes të prodhuara prej grantmarrësve, që mund të shërbejnë si baza/referenca dhe të integrohen në projekt-ide të reja me efekt të lartë dhe ndikim të shumëfishuar, në thirrjet e tjera për aplikime.

Projekti ka kontribuar në ndërtimin e kapaciteteve të OSHC-ve, komuniteteve dhe individëve në kërkime shkencore dhe ndërhyrje bazuar në evidenca, si edhe në futjen e praktikave dhe qasjeve novatore; rekomandohet që këto praktika/qasje të replikohen dhe të vijohen më tej.


Mjaft aktivitete kanë synuar të çimentojnë rezultatet e granteve, me qëllim përhapjen e historive të suksesit të grantmarrësve, si edhe ndarjen e mësimëve të nxjerra me publikun e gjerë, por edhe mes grantmarrësve, për të mësuar nga përvojat e përbashkëta (ndërmjet bashkive ose rajoneve) dhe për të rritur bashkëpunimin dhe partneritetet. Në vitin e tretë të fazës së zbatimit, projekti do të inkurajojë partneritetet mes organizatave të shoqërisë civile/individëve, duke mbështetur ide për grante të ngjashme me ato që janë zbatuar tashmë, veçanërisht në mbështetje të OSHC-ve (të reja) në zonat periferike.

Produkti 1.1: Grantet me bazë kërkese, grantet individuale dhe aksionet e Reagimit të Shpejtë (kur kërkohen) financohen dhe zbatohen me sukses.


Deri më sot, të gjitha grantet janë zbatuar normalisht dhe kanë prodhuar efekte të prekshme te komunitetet përkatëse.

a. Grantet me bazë kërkese

Panorama e thirrjeve për aplikime:



Geographic Distribution for the 3 Calls



Shpërndarja gjeografike e aplikantëve sipas origjinës dhe zonës së zbatimit

Për sa i përket origjinës së përfituesve të granteve, ekziston një mospërputhje krahasuar me zonën e zbatimit, pasi 64% e grantmarrësve e zbatojnë projektin jashtë zonës së tyre të origjinës. Në shumicën e rasteve, organizata me seli në Tiranë zbatojnë projekte në zona shumë të largëta si në Bulqizë, Mat, Përrenjas, Maliq, Përmet, Librazhd, Cërrik etj. Megjithatë, këto projekte zbatohen në partneritet me aktorët lokalë.

Efekt direkt i nismave të mbështetura prej LA është edhe numri i lartë i peticioneve drejtuar autoriteteve vendore për problematika të ndryshme që shqetësojnë komunitetet vendore. Përmes skemës së granteve, LA ka mbështetur 15 peticione, konkretisht:


- Peticioni i nënshkruar nga 2,000 pjesëtarë të komunitetit të Luginës së Vjosës dërguar Kryeministrit, ku kërkohet anulimi i ndërtimit të hidrocentralit mbi lumin Vjosa dhe dhënien e statusit të Parkut Kombëtar;
- Peticioni i nënshkruar nga 1,200 pjesëtarë të komunitetit për hapjen e qendrës rinore në bashkinë Kamzë, e cila u përfshi në axhendën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak në Mars 2017, por është ende pezull;
- 6 peticione në Pogradec për përmirësimin e infrastrukturës e parqeve çlodhëse;
- 2 peticione drejtuar përkatësisht NjA Baldushk dhe Krrabë, Tiranë, ku kërkohet ndërtimi i urës Kociaj-Veski (e përfshirë në buxhetin e 2017) dhe asfaltimin e rrugës Skuterrë-Qendër (pezull);
- Peticioni nga komuniteti i NjA Shirgjan/Muriqan në Elbasan për vendosjen e kazanëve të mbeturinave (zgjidhur);
- Peticioni i komunitetit të NjA Torovicë, Lezhë, për pastrimin e sistemit të vaditjes si masë për parandalimin e përmytjeve (pezull);

- 2 peticione nga komuniteti i NjA Novoselë në Vlorë për asfaltimin e rrugës në fshatin Akerni (zgjdhur) dhe peticioni në NjA Orikum, Vlorë, ku kërkohet ndërhyrje në sistemin e kanalizimeve për të ndaluar shkarkimin e ujërave të zeza në det, gjë që ndikon negativisht në turizëm (pezull);
- Peticioni i komunitetit të ish-kënetës në Maliq dhe në qarkun e Korçës, nënshkruar nga 450 banorë dhe dërguar Kryeministrit, ku i kërkohet qeverisë të tërheqë projekt-ligjin për përdorimin e torfës për energji alternative.

Skema e granteve e zbatuar deri tani dallohet për lehtësinë e aplikimit dhe procedurat e standardizuara, duke iu mundësuar OSHC-ve të vogla dhe individëve që të konkurrojnë për idetë e tyre autentike në komunitetet e tyre të vogla. Për të fuqizuar më tej procesin, LA do të ndërmarrë këto hapa:

- Nxitjen e pjesëmarrjes së OSHC-ve të vogla dhe individëve në thirrjet e ardhshme për aplikime;
- Futjen e mekanizmit të vijueshmërisë duke filluar nga Thirrja nr. 4 për Aplikime;
- Standardizimin e procedurës së aplikimit dhe vlerësimit, si edhe rishikimin e limiteve të granteve;
- Ndjekjen e ndikimeve praktike të nismave të mbështetura nga thirrjet e mëparshme për aplikime, si edhe forcimin e bashkëpunimit me autoritetet vendore për të shtrirë më tej efektet e ndërhyrjeve.

Projektet e financuara nën Thirrjen nr. 2 dhe nr. 3 për Aplikime janë ende në zbatim, por bazuar në raportin e vlerësimit të Thirrjes nr. 1 dhe nr. 2 për Aplikime, ekzistojnë prova thelbësore se projektet kanë kontribuar në rezultatet e mëposhtme:



Në dy thirrjet për aplikime që do të realizohen, LA do të rrisë numrin e kriterëve për stimulimin e partneriteteve mes aplikantëve dhe do të përfshijë OSHC-të e vogla dhe të reja dhe individë nga qytetet e vogla dhe të largëta të Shqipërisë, që do të aplikojnë në partneritet me OSHC-të e konsoliduara.

b. Asistenca e Reagimit të Shpejtë

Aktualisht katër (4) projekte janë mbështetur përmes këtij instrumenti. Gjatë periudhës raportuese, LA ka kontraktuar tre projekte të Reagimit të Shpejtë që kanë adresuar problematika të mbrojtjes mjedisore. Megjithatë adresonin problematika vendore, projektet e mbështetura synonin advokim në nivel kombëtar, pasi me ndikim kombëtar ishte edhe projekti që synonte mosdekretimin e Ligjit për Importin e Mbetjeve, i zbatuar nga Aleanca Kombëtare kundër Importit të Plehrave (AKIP). AKIP mbështeti lëvizjen e një grupi qytetarësh kundër ndryshimeve ligjore në ligjin për menaxhimin e integruar të mbetjeve. Kjo fushatë intensive rezultoi në këto arritje:

- Përmirësimin e projekt-ligjit për menaxhimin e integruar të mbetjeve, duke përfshirë një dispozitë të posaçme për përfshirjen e shoqërisë civile në monitorimin e importit të mbetjeve;
- Presidenti i Republikës së Shqipërisë nuk e dekretoi ligjin e miratuar nga Parlamenti dhe e ktheu për përmirësime;
- Parlamenti, në sesionin e ri në Shtator 2017, miratoi dekretin e Presidentit dhe qeveria do të nisë konsultimin publik për Ligjin mbi Importin e Mbetjeve para se t'i paraqitet Parlamentit sërish për miratim.

Projekti i zbatuar nga “Shoqata e Përfitimit Fizik” kërkoi tërheqjen nga qeveria të projekt-ligjit që synon përdorimin e torfës për prodhimin e energjisë elektrike dhe ngrohjen me avull. Projekti i fokusoi aktivitetet në dy drejtime kryesore: (i) ndërgjegjësimin e qytetarëve të Maliqit; dhe (ii) advokimin pranë Qeverisë dhe deputetëve të Parlamentit që të tërheqin projekt-ligjin “Për miratimin e ndryshimit të statusit të një toke bujqësore, me sipërfaqe 288.4 ha, në zonën minerare, për shfrytëzimin e torfave për prodhimin e energjisë elektrike”. Projekti organizoi 17 dëgjesa publike me komunitetin, takime me kryetarët e bashkive Korçë, Maliq dhe Pogradec, si dhe takime me deputetët e Komisionit për Aktivitetet Prodhuese. Rreth 450 qytetarë nënshkruan një peticion drejtuar Qeverisë dhe Parlamentit. Falë masave intensive advokuese, Parlamenti ende nuk e ka miratuar këtë projekt-ligj.

Rezultatet e arritura deri tani janë në linjë me objektivat e parashikuar në Dokumentin e Projektit të LA. Projekti mori një numër të lartë aplikimesh për këtë instrument, edhe pse mbi 80% e tyre nuk përmbushnin kërkesat dhe ishin më të përshtatshëm për thirrje të zakonshme për aplikime, sesa për Instrumentin e Reagimit të Shpejtë. LA do të forcojë komunikimin dhe do të përmirësojë rubrikën e faqes së internetit për këtë instrument, i cili do të vazhdojë të ruajë natyrën e vet dhe do të përdoret në periudhat midis thirrjeve për aplikime. Edhe procedura e miratimit do të përshpejtohet.

Produkti 1.2: Kapacitetet e aktorëve të shoqërisë civile dhe individëve (përfshirë median) për të influencuar në demokracinë vendore përmirësohen përmes trajnimit dhe formimit të rrjeteve.

Ky Produkt adresohet përmes përpjekjeve të përbashkëta. Së pari, LA organizoi disa aktivitete për forcim kapacitësh për grantmarrësit dhe aplikantët potencialë. Këto aktivitete kishin synim të përcaktuar dhe u fokusuan në rritjen e kapaciteteve të kandidatëve dhe grantmarrësve për të kuptuar qeverisjen vendore, fushat e ndryshme të ndërhyrjes relevante për projektin, si edhe në përmirësimin e kapaciteteve në menaxhimin dhe zbatimin e projekteve. Në një valë të dytë ndërhyrjeje, përmes IMS zbatohet një komponent i gjerë trajnimi për të gjitha OSHC-të me fokus çështjet e qeverisjes vendore².

Produkti 1.3: Kapacitetet e gazetarëve lokalë që të luajnë rol thelbësor në përparimin e demokracisë vendore forcohen përmes trajnimeve praktike dhe burimeve.

Përdorimi i medias dhe teknikave të komunikimit luajti rol vendimtar në të gjitha projektet, ndërkohë që edhe vetë LA i përdor gjerësisht mjetet e komunikimit. Të gjitha projektet përdorën gjerësisht median dhe LA i trajnoi mbi teknikat e medias dhe përdorimin e tyre.

² Shih seksionin më poshtë për informacion të hollësishëm.

Një tjetër komponent i rëndësishëm i këtij Produkti është edhe forcimi i kapaciteteve të gazetarëve lokalë. Grantet e mbështetura nga LA trajnuan mbi 150 gazetarë lokalë mbi të drejtën e informimit, kontratat publike, procesin e buxhetimit vendor, etj.³. Edhe pse janë disa trajnime sporadike për gazetarët mbi demokracinë vendore, LA do ta strukturojë ndërhyrjen në këtë fushë përmes projektit të ri IMS, zbatim i të cilit ka filluar në Shtator 2017.

Rezultati 2: Aktorët e shoqërisë civile ndërmarrin dhe mbështesin ndryshime strukturore për të përmirësuar demokracinë në nivel vendor.

Rezultati 2 përbën një qëllim afatgjatë të projektit dhe mbulon kryesisht qëndrueshmërinë e ndërhyrjeve. Ndërhyrjet në kuadrin e këtij Rezultati bazohen më së shumti në përdorimin e Instrumenteve Mundësues Strategjike (IMS) në mbështetje të shoqërisë civile dhe grupeve të tjera të interesuara për të përmirësuar demokracinë vendore dhe për të arritur ndryshime strukturore.

Përveç dy projekteve IMS të zbatuar deri tani gjatë kësaj faze, u miratuan dy IMS shtesë në Shtator 2017:

- Ngritjen e dy qendrave ligjore vendore;
- Fuqizimin e mediave vendore - platforma multifunkionale për të mbështetur demokracinë vendore.

Indikatorët	Objektivat 2015-2019	Situata
2.1 Përdorimi i IMS për të sjellë ndryshim në nivel vendor.	2.1 Deri në fund të projektit, qytetarët dhe aktorët e shoqërisë civile në Shqipëri do të përdorin IMS në përpjekjet e tyre për të forcuar demokracinë në nivel vendor ⁴ .	2.1 Të paktën 7 grantmarrës të mbështetur nga LA përdorin gjerësisht instrumentin IMS financatvendore.al për advokim me baza evidence me bashkinë dhe portali ka pasur 36,859 vizitorë.
2.2 Llojet e instrumenteve dhe kuadreve që lehtësojnë punën e 'avokatëve' të demokracisë në nivel vendor.	2.2 'Avokatët' e demokracisë që punojnë në nivel vendor dhe kombëtar (përfshirë institucionet publike) përfitojnë nga ligjet, politikat, praktikat, platformat dhe informacionet e reja që i ndihmojnë të punojnë më me efektivitet.	2.2 Përmes instrumentit IMS, LA ka realizuar 5 platforma që 'avokatët' e demokracisë vendore i përdorin për të përmirësuar punën e tyre: <ol style="list-style-type: none"> 1. Platforma e transparencës së bashkisë: www.financatvendore.al; 2. Ndërfaqja <i>online</i> për OSHC-të, platformë që përdoret për sesione trajnimi, këshillimi dhe shkëmbim praktikash të mira rajonale <i>online</i>; 3. www.pushtetivendor.al media <i>online</i> kushtuar qeverisjes vendore, zbatuar nga BIRN Albania; 4. www.openprocurement.al/zbatuar nga Instituti Shqiptar i Shkencave, ku janë publikuar të gjitha kontratat e bashkive; 5. www.unemonitoroj.com, faqe interneti e krijuar nga Forumi i Mendimit të Lirë ku janë publikuar premtimet zgjedhore të Kryetarëve të Bashkive Tiranë, Vlorë, Lezhë dhe Elbasan. Faqja e internetit iu mundëson qytetarëve të denoncojnë raste në zonat e tyre që lidhen me qeverisjen vendore. <p>Gjithashtu, raporti kombëtar për transparencën proaktive po përdoret gjerësisht nga 'avokatët' e demokracisë vendore. Raporti është përgatitur nga BIRN Albania.</p>
2.3. Përqindja e projekteve që përdorin median dhe median sociale.	2.3 Media është angazhuar (direkt ose indirekt) në forcimin e demokracisë vendore dhe në nxitjen e llogaridhënies shoqërore në 50% të projekteve.	2.3 100% e projekteve të financuara kanë përdorur gjerësisht median dhe median sociale.

³ Projekte të zbatuara nga Instituti i Shqiptar Shkencave, BIRN Albania, Instituti Shqiptar i Medias dhe IPPM.

⁴ Përfshin ndryshime si presioni në rritje i OSHC-ve dhe medias ndaj autoriteteve publike vendore duke shfrytëzuar të dhënat bazuar në evidence, me qëllim përmirësimin e qeverisjes; si edhe advokim aktiv të qytetarëve për përmirësimin e shërbimeve të ofruara në nivel vendor.

Produkti 2.2: Forcimi i OSHC-ve për përfshirje efektive dhe pjesëmarrje në politikëbërje dhe vendimmarrje.

Aktivitetet nën këtë Produkt zbatohen në kuadrin e projektit IMS që zbatohet nga Partnerët Shqipëri (PSh). Shtyllat kryesore të ndërhyrjeve kanë qenë:

1. Krijimi i ndërfaqes *online*;
2. Ofrimi i trajnimeve (në terren dhe *online*);
3. Këshillim individual dhe formim rrjetesh.

Edhe pse projekti filloi në Tetor 2016, më shumë se 196 pjesëmarrës janë trajnuar dhe kanë marrë pjesë në programe trajnimi intensiv dhe në sesionet e formimit të rrjeteve. Projekti siguroi shpërndarje të pjesëmarrësve (kryesisht duke u fokusuar në OJF-të dhe aktivistët me pak përvojë) dhe jashtë Tiranës. Shkurtimisht, aktivitetet kryesore të këtij projekti janë si më poshtë:

- Ndërtimi i ndërfaqes në internet për trajnime dhe këshillime *online* si edhe organizimin e seancave *online* për shkëmbimin e praktikave më të mira rajonale;
- Pesë sesione trajnimi (dy ditë, secili në terren) në: Mobilizim të Komunitetit (3 seanca) dhe Shkrim të Projekt-Propozimeve (2 sesione);
- Dy sesione trajnime *online* me temë: Qeverisja me Pjesëmarrje dhe Mobilizimi i Komunitetit;
- Tre Sesione Tematike për Formim Rrjetesh me grantmarrësit e LA të Thirrjeve nr. 1 dhe nr. 2 për Aplikime me temë: Mobilizimi i Komunitetit; Mobilizimi i Të Rinjve; dhe Advokimi dhe Monitorimi i Qeverisjes Vendore. Në sesione morën pjesë 32 pjesëmarrës që përfaqësonin 20 grantmarrës;
- Dy sesione *online* për Formim Rrjetesh Rajonale me: Organizatën GONG nga Kroacia dhe organizatën GAP nga Kosova. Në të dy sesionet morën pjesë gjithsej 33 persona;
- Tetë (8) sesione këshillimi me grantmarrës të LA (5 *online* dhe 3 në terren) me 8 organizata.

Në shifra:

- Në total, pranë Partnerët Shqipëri u dorëzuan 455 aplikime për aktivitetet e lartpërmendura;
- 196 persona përfituan nga aktivitetet e lartpërmendura. Shumica e pjesëmarrësve ishin femra (77%);
- Në total, projekti trajnoi 123 pjesëmarrës përmes dy trajnimeve të instrumentit *online* dhe në terren;
- Vihet re kërkesë në rritje e aplikimeve për të marrë pjesë ose në trajnimin në terren, ose në atë *online*; nga 331 aplikantë, 290 nuk janë grantmarrës të LA (98 prej tyre morën pjesë në trajnime);
- Projekti siguroi shpërndarje të barabartë të pjesëmarrësve për sa i përket origjinës gjeografike;
- Me gjithë numrin e lartë të aplikimeve që vijnë nga organizatat me bazë në Tiranë (74% e totalit të aplikimeve), në rastin e përfituesve të trajnimeve, vetëm 50% e pjesëmarrësve janë nga Tirana (54 nga 109 pjesëmarrës).

PSh ka zbatuar për herë të parë trajnimet *online*, një qasje novatore në fushën e teknologjisë së edukimit. Gjatë vitit të parë të zbatimit, PSh organizoi 3 trajnime *online*. Ndërfaqja *online* e përdorur ishte GoToTraining. Edhe pse përbënte risi, kjo qasje u kërkuar dhe u vlerësua shumë nga pjesëmarrësit. Për shumicën e tyre ishte hera e parë që merrnin pjesë në trajnim *online* dhe ndërveprimi, përfshirja, angazhimi dhe komunikimi ishin të ngjashme si në trajnimet në terren. PSh ftoi jo vetëm grantmarrësit e LA, por edhe OSHC-të të tjera që synojnë të aplikojnë në thirrjen për aplikime të LA. Më konkretisht, PSh mori 75 aplikime për pjesëmarrje në trajnimet *online* dhe 44 u përzgjedhën për të marrë pjesë në këto sesione.

Përveç trajnimeve tradicionale dhe *online*, Partnerët Shqipëri organizoi këshillim individual për grantmarrësit e LA. Organizatat u përzgjedhën në partneritet me personelin e LA (8 grantmarrës të LA). Qëllimi i këshillimit individual ishte orientimi dhe mbështetja e grantmarrësve bazuar në nevojat dhe sfidat e tyre në zbatimin e projekteve që kanë. Personeli i Partnerët Shqipëri informoi të gjithë grantmarrësit e përzgjedhur për qëllimin e sesionit këshillues dhe bashkë me ta vendosi të organizojnë këshillimin.

Këshillimi individual u organizua si në terren, ashtu edhe *online*. Në tërësi, të gjithë përfituesit e përzgjedhur e vlerësuan mbështetjen dhe ndanë sfidat dhe nevojat e tyre me këshilluesit. Një sfidë e përbashkët me të cilën përballëshin organizatat e përzgjedhura ishte mungesa e bashkëpunimit të Këshillave Bashkiakë me projektet e tyre, sidomos në qarqet e Kukësit dhe Lezhës, ku mbledhjet e Këshillave Bashkiakë nuk ishin mbështetës për ndërhyrjet vendore të organizatave.

Paralelisht, Partnerët Shqipëri organizoi dhe zhvilloi raundin e parë të Sesioneve Tematike për Formim Rrjetesh për grantmarrësit e LA.

Qëllimi i sesioneve tematike për formim rrjetesh ishte prezantimi dhe diskutimi i nevojave dhe sfidave që hasin grantmarrësit e LA gjatë zbatimit të projekteve të tyre. Gjithashtu, këto sesione tematike shërbyen për të ndarë përvojat (praktikat e mira dhe mësimet e nxjerra) midis përfituesve të LA që po zbatojnë nisma të ngjashme, me qëllim identifikimin e mundësive për bashkëpunim dhe aktivitete të përbashkëta.

Grantmarrësit e LA u ndanë në tri grupe kryesore bazuar në temat si më poshtë:

1. Mobilizimi i Komunitetit, organizuar më 14 Shkurt në Bashkinë Vorë.
2. Mobilizimi i Të Rinjve, organizuar më 21 Shkurt në Bashkinë Durrës.
3. Advokimi dhe Monitorimi i Qeverisjes Vendore, organizuar më 24 Shkurt në Tiranë.

Këto sesione u organizuan për grantmarrësit LA të Thirrjes nr. 1 dhe nr. 2 për Aplikime; gjithsej u ftuan 41 organizata dhe individë. Të pranishmit në total ishin 32 persona, që përfaqësonin 20 organizata dhe 4 përfitues individualë.

Përveç mbështetjes së formimit të rrjeteve nga OSHC-të me homologët e tyre vendas, Partnerët Shqipëri organizoi dy sesione *online* formimi rrjetesh me organizatat rajonale. Qëllimi i sesioneve ishte të mundësonte ndarjen dhe shkëmbimin e përvojave, mësimet e nxjerra dhe praktikave të mira nga rajoni gjatë zbatimit të nismave të ngjashme me ato të zbatuara nga aktorët e shoqërisë civile të mbështetur nga LA.

Sesioni i parë i formimit të rrjeteve rajonale u organizua më 4 Prill me ekspertin nga Fondacioni Gong, një organizatë e mirënjohur nga Kroacia, ku morën pjesë 17 vetë. Sesioni i dytë i formimit të rrjeteve rajonale u organizua *online* më 2 Qershor 2017, me ekspertë nga Instituti GAP në Kosovë, që solli përvojën e vet në aktivitetet e advokimit të zbatuara nga instituti për rritjen e transparencës dhe llogaridhënies së qeverisjes vendore në Kosovë (16 pjesëmarrës morën pjesë).

Produkti 2.3: Platforma me të dhëna të hapura për matjen e performancës fiskale dhe financiare të qeverisjes vendore, e krijuar me mbështetjen e Co-PLAN dhe OSFA dhe e aksesuar nga palët e interesuara.

Kur ka kaluar një vit që është aktive, platforma për herë të parë ofron të dhënat financiare të bashkive (përfshirë të ardhurat dhe shpenzimet) për të gjitha NjQV-të në Shqipëri në mënyrë sistematike që në 2010, duke dhënë një panoramë të çmuar të situatës para dhe pas Reformës Territoriale Administrative.

Platforma ofron të dhënat financiare të bashkive në mënyrë të thjeshtë dhe të përdorshme për publikun. Të gjithë grafikët dhe raportet e gjeneruara nga platforma mund të shkarkohen. Gjatë vitit të kaluar, platforma ka pasur 36,859 shikues, që shënon rritje me pothuaj 400% gjatë gjysmës së parë të 2017 krahasuar me gjysmën e parë të 2016.

Vitin e kaluar, puna me Platformën Financiare Bashkiake është fokusuar në tre fronte kryesore:

1. Arkitektura e re e platformës që synon të rrisë përdorimin e kollajtë për përdoruesin

Versioni i ri i platformës po projektohet me qëllimin parësor që të lehtësojë përdorimin për përdoruesit, duke rritur numrin e analizave që ofron dhe vizualizimeve. Për përdoruesit e zakonshëm, përfshirë qytetarët, median, etj., platforma ofron indikatorë të paracaktuar si:

- Nga vijë paratë – katër indikatorë të ndryshëm tregojnë strukturën dhe realizimin në kohë të të ardhurave të qeverisjes vendore, ku njëri bën ndarjen në tarifa dhe taksa individuale;

- Si përdoret nga bashkitë – pesë indikatorë tregojnë strukturën dhe realizimin në kohë të shpenzimeve të qeverisjes vendore, si p.sh.:
 - ✓ Sa para përdoren për pagat e personelit, sa për kostot operative, sa për investimet - bazuar në natyrën ekonomike;
 - ✓ Ndarja e kostove operative bazuar në strukturën e shpenzimeve, që është një risi sepse qeverisja vendore nuk e raporton këtë;
 - ✓ Ndarja e investimeve sipas sektorëve, duke treguar se në cilin sektor bashkitë investojnë më shumë - bazuar në strukturën e shpenzimeve;
 - ✓ Ndarja e totalit të shpenzimeve sipas sektorëve; që tregon se në cilat funksione bashkitë shpenzojnë më shumë, pra jo vetëm investimet;
 - ✓ Ndarja e të gjitha shpenzimeve sipas burimit të financimit; një grafik i paracaktuar tregon sa financohet nga vetë të ardhurat e qeverisjes vendore dhe sa financohet përmes granteve të kushtëzuara.

Për të gjitha llojet e grafikëve të shpenzimeve, përdoruesi mund të zgjedhë të shohë sa financohet nga vetë qeverisja vendore (nga të ardhurat tatimore, grantet e pakushtëzuara, taksat e përbashkëta) dhe shuma që financohet nga grantet e kushtëzuara të qeverisë.

Për përdoruesit e avancuar, përfshirë median e specializuar, studiuesit, vetë bashkitë, akademikët dhe ekspertët, arkitektura e re mundëson një numër analizash të detajuara dhe informacion nga indikatorë financiarë si autonomia fiskale dhe performanca financiare, përveç mundësisë për të krahasuar performancën e disa bashkive përgjatë një numri vitesh për një apo disa indikatorë përmes dy llojeve të ndryshme të vizualizimeve.

E gjithë kjo rrit transparencën e qeverisjes vendore në përdorimin e fondeve publike dhe siguron informacion të çmuar për hartimin e politikave, planifikimin e buxhetit vendor, raportimet e medias, punimet shkencore, esetë, vizualizimet grafike, etj.

2. Kalimi nga të dhënat te informacioni

Gjatë vitit të kaluar, platforma e ka rritur frekuencën e përpunimit dhe publikimit të të dhënave nga baza vjetore në 3-mujore. Kjo do të thotë se përdoruesit nuk kanë pse presin deri në fund të vitit fiskal për të pasur një pasqyrë të qartë të performancës së bashkisë, por mund të monitorojnë në baza 3-mujore, duke rritur shanset për veprime korrigjuese ose çfarëdolloj pune advokuese që të jetë e bazuar në të dhëna dhe në evidenca.

Kjo bën që monitorimi i projekteve dhe nismave të ketë një burim të besueshëm sistematik të dhënash dhe informacioni për të identifikuar projekt-idetë, ose inputin për çdo aktivitet projekti.

Me të njëjtën frekuencë, ekipi punon për përpilimin e raporteve 3-mujore dhe vjetore, të cilat ofrojnë një përmbledhje konçize për tendencat e vëna re gjatë periudhës 3-mujore ose 1-vjeçare, duke kaluar nga "të dhënat" në "informacion të vlefshëm dhe të përdorshëm".

Raportet publikohen në faqen e internetit, shkarkohen dhe shpërndahen elektronikisht me një bazë të dhënash të madhe që përbëhet nga profile të ndryshme përdoruesish. Shembulli më i fundit është ai i Raportit "Financat e Pushtetit Lokal 2016: Nga vijnë paratë dhe si përdoren nga bashkitë", si pjesë e Javës për Demokraci të LA, në Prill 2017.

Raporti u botua në dy gjuhë (shqip dhe anglisht) dhe u shpërnda gjerësisht te partnerët, organizatat e medias dhe grupeve të ndryshme të synuara, duke sjellë si rezultat botimin e një sërë artikujsh (linqet më poshtë).

3. *Promovimi i platformës si burim i besueshëm të dhënash për median, studiuesit, vetë bashkitë, studentët, organizatat, etj.*

Gjatë gjysmës së parë të vitit 2017, platforma është përdorur si burim të dhënash nga media të ndryshme (në të paktën 13 raste), duke përfshirë median e shkruar, televizione dhe *online*⁵. Për të siguruar që platforma të mos jetë thjesht aty, por edhe të përdoret nga grupet e synuara si OSHC-të, akademikët, studiuesit, organizatat e medias, aktivistët, njësitë e qeverisjes vendore etj., platforma është prezantuar në një numër trajnimesh tematike dhe sesione informimi. Kurdo që ishte e mundur, platforma është prezantuar dhe integruar në aktivitete të tjera organizative, fokusi i të cilave ishte qeverisja vendore (në të paktën 7 raste).

Rezultatet e arritura gjatë vitit të parë janë:

1. *Rritje e transparencës* në qeverisje, kryesisht në nivel vendor, përmes përhapjes dhe shkëmbimit të të dhënave për OSHC-të, qytetarët dhe grupet e tjera të interesuara. Gjashtë raporte 3-mujore dhe vjetore dhe një buletin për financat bashkiake janë qarkulluar ndërmjet grupeve të synuara.
2. *Rritje të besueshmërisë dhe llogaridhënies* së qeverisjes vendore, duke gjeneruar dhe bërë publike një sërë krahasimesh, qoftë ndërmjet autoriteteve vendore brenda vendit dhe në rajon, qytetarëve dhe grupeve të tjera të interesuara, duke dhënë një analizë të qartë të situatës dhe performancës financiare të NjQV-ve. Veçoritë e reja të platformës mundësojnë krahasime mes viteve të ndryshme për çdo NjQV dhe ndërmjet NjQV-ve të ndryshme.
3. *Përmirësim i dialogut* ndërmjet grupeve të synuara dhe rritje të angazhimit në aspektet përkatëse, ose që kanë të bëjnë me financat vendore.
4. *Përmirësim i praktikave të vendimmarrjes* që i përkasin ose kanë të bëjnë me fushën e financave, të cilat janë të bazuara në evidenca.

⁵<http://www.monitor.al/analiza-investimet-kapitale-te-bashkive-rane-16-ne-9-mujorin-e-2016/>.

<http://www.panorama.com.al/analiza-shifrat-si-rane-investimet-kapitale-te-bashkive/>; <http://www.albeu.com/shqiperi/bashkite-harxhojne-71-te-fondeve-vetem-per-paga/302084/>.

<https://www.scan-tv.com/fondet-per-vendoret-raporti-si-perdoren-parate-nga-bashkite-e-reja/>.

<http://www.oranews.tv/ekonomi/ne-site-financat-e-bashkive-taksa-e-prones-kontribuesi-krjesor/>.

<http://www.oranews.tv/puntate/para-e-pasuri-fondet-e-bashkive-ligji-i-ri-per-decentralizimin/>.

<http://shekulli.com.al/p.php?id=620056&fondet-per-vendoret-raporti-si-perdoren-parate-nga-bashkite-e-reja>.

<https://opozita.com/2017/03/analiza-investimet-kapitale-te-bashkive-rane-16-ne-9-mujorin-e-2016/>.

https://shtetiweb.org/wp-content/uploads/2017/05/Raporti_2016_ACIR0_01052017_Disseminated.pdf.

<https://www.youtube.com/watch?v=etqmWHv72ZQ> (Scan TV coverage); <https://www.youtube.com/watch?v=OBlyaltKDw> (Scan TV coverage); <http://www.oranews.tv/puntate/para-e-pasuri-fondet-e-bashkive-ligji-i-ri-per-decentralizimin/>;

<https://www.youtube.com/watch?v=pFHtyO73Y3A> (Ora News coverage).

Kapitulli 3: Modalitetet e Zbatimit

a. Monitorimi dhe vlerësimi

LA i ka kushtuar vëmendje të madhe monitorimit dhe zbatimit në kohë të aktiviteteve, duke iu dhënë njëkohësisht mbështetje grantmarrësve dhe individëve gjatë procesit. Për këtë qëllim, janë përdorur disa instrumente:

- *Raporti përshkrues/financiar i grantit*: 66 raporte (grantmarrësit e Thirrjes nr. 1 dhe nr. 2 për Aplikime + 3 të Reagimit të Shpejtë) kanë pasur raport final dhe/ose të ndërmjetëm të miratuar;
- *Monitorimi i grantmarrësve/individëve*: të paktën 82 vizita monitoruese (përfshirë monitorimin në terren); një rezultat i drejtpërdrejtë i këtij monitorimi të ngushtë është fakti se 100% e projekteve të mbyllura (31 projekte nga 78) kanë përmbushur objektivat e përgjithshëm të projektit dhe të gjitha kishin raportet përfundimtare përshkruese dhe financiare të miratuara nga LA. Vizitat monitoruese dhe takimet ishin shumë të rëndësishme edhe për të diskutuar mbi shumë çështje me grantmarrësit dhe për t'iu dhënë mbështetje/orientim për tema të ndryshme. Pas këtyre takimeve, projekti vuri re përmirësime të prekshme në praktikën e zbatimit, dokumentet e raportimit dhe trajtimin e situatave të ndryshme;
- *Vlerësimi i jashtëm*: Projekti realizoi vlerësim të jashtëm të granteve nën Thirrjen nr. 1 për Aplikime, 5 granteve nën Thirrjen nr. 2 për Aplikime dhe tre projekteve nën asistencën e Reagimit të Shpejtë. Ky vlerësim u përdor si mjet shtesë për të vlerësuar produktet e granteve dhe ndikimet potenciale. Gjetjet ishin shumë të rëndësishme për adresimin e disa problematikave, si edhe për të vendosur mbi tema të ndryshme që lidhen me zbatimin. Për këtë arsye, LA do të përsërisë këtë lloj vlerësimi të jashtëm për të gjitha thirrjet për aplikime dhe do të shkojë një hap më tutje duke kontrolluar në terren ndikimet e sjella prej projekteve të zbatuara.

Pas dy vitesh zbatim, LA iu nënshtrua një *procesi rishikimi të brendshëm afatmesëm* në Qershor 2017. Ky ushtrim shërbeu për të pasur një diskutim të hapur dhe rrahje idesh midis anëtarëve të konsorciumit të LA, personelit të LA dhe Ambasadës Zvicerane mbi aktivitetet, rezultatet dhe ndikimet e projektit, si edhe pritshmëritë për të ardhmen.

b. Perspektiva gjinore

LA ka vazhduar ta përfshijë perspektivën gjinore në aktivitetet dhe grantet e saj. Nga 78 grante, LA ka mbështetur gjashtë organizata të grave, ndërsa 50% e individëve grantmarrës janë femra (11 nga 22). LA ndërmoi disa hapa konkretë në vitin e dytë të zbatimit që përfshijnë dhënien e mbështetjes për grantmarrësit që të kenë perspektivën gjinore në aktivitetet ditore dhe raportet e tyre, si edhe të shkëmbejnë përvojat me grantmarrësit e tjerë se si të përfshijnë çështjet gjinore në projektet e mbështetura nga LA. Më 24 Mars 2017 u organizua një seminar *peer-to-peer* me grantmarrësit e Thirrjes nr. 1 dhe nr. 2 për Aplikime për të ndarë modelet se si projektet pa perspektivë gjinore të kenë rezultate konkrete gjinore.

Edhe pse projektet e Thirrjes nr. 1 dhe nr. 2 për Aplikime nuk fokusoheshin në perspektivën gjinore, elementë të ndryshëm interesantë në lidhje me barazinë gjinore dhe perspektivën gjinore u materializuan gjatë zbatimit të komponentëve apo aktiviteteve të projekteve të ndryshme. 36.3% e grantmarrësve kanë pasur fokus të qartë dhe kanë arritur të realizojnë pjesëmarrje të barabartë të grave dhe burrave, ose djemve dhe vajzave në aktivitetet e tyre të planifikuara. Ky element i pjesëmarrjes së barabartë ishte veçanërisht i rëndësishëm në zonat e vogla urbane apo suburbane të vendit (p.sh. në Bulqizë, një qytet i vogël plot me stereotipe dhe paragjykime gjinore dhe me mundësi shumë të kufizuara për angazhimin aktiv të grave dhe vajzave në jetën shoqërore).

54.5% e grantmarrësve kanë ndikuar në rritjen e vizibilitetit të grave dhe vajzave në jetën publike, përmes aktiviteteve të ndryshme, p.sh. krijimin e strukturave të ndryshme, përdorimin e medias për të raportuar shqetësimet e qytetarëve, monitorimin e transparencës së vetëqeverisjes vendore, etj.

“...Ne ishim një grup djemsh dhe vajzash dhe kur planifikuam projekt-idenë dhe e paraqitëm si projekt-propozim pranë LA, nuk kishim menduar kurrë për pjesëmarrjen e vajzave apo përfshirjen e komponentit gjinor në aktivitetet tona. Por, gjatë zbatimit të projektit, e kuptuam se disa shkolla kishin më shumë vajza sesa djem të gatshëm për të marrë pjesë dhe për t'u angazhuar aktivisht në aktivitetet tona, sidomos në takimet e Bordit Rinor me përfaqësues të ndryshëm të Bashkisë apo Këshillit Bashkiak. Falë mbështetjes së LA, mësuam si të përdorim këtë tendencë për të arritur më mirë rezultatet tona. Ne mësuam si të përdorim njohuritë dhe angazhimin e vajzave në dobi të të gjithë komunitetit të të rinjve në Vorë. Në shumë raste, i afrohem grupëve të synuara përmes angazhimit të posaçëm të vajzave në projektin tonë...”

G. Hajdari, grantmarrës individ “Bordi Rinor Këshillimor në Vorë”

Instituti i Shqiptar Shkencave, grantmarrës i Thirrjes nr. 2 për Aplikime, realizoi një analizë kombëtare për "Perspektivën gjinore të kontratave publike në pushtetin vendor". Kjo është hera e parë që një analizë e tillë realizohet në Shqipëri dhe është instrument shumë kuptimplotë për advokimin me bazë evidencash. Analiza nënvizoi një numër të vogël kontratash publike me shoqëri me pronarë apo administratore femra në 61 bashki. Vetëm 3.2% e vlerës totale të kontratave është nënshkruar me subjekte që zotërohen apo administrohen nga femrat, ose 5% i numrit të të gjitha kontratave, pavarësisht faktit se 30% e shoqërive tregtare zotërohen nga femrat.

... Bulqiza është një qytet i vogël në veri të Shqipërisë që njihet për industrinë e kromit. Hera e parë që një vajzë angazhohet në një projekt të mbështetur nga LA, e cila solli zërin e rinisë në TV lokal për menaxhimin e mbetjeve. Ajo theu një tabu në lidhje me pozitën e vajzave në familje dhe në jetën publike dhe shërbeu si model pozitiv për të frymëzuar dhe për të nxitur angazhimin aktiv të shumë më tepër vajzave dhe grave që të marrin pjesë në aktivitetet e projektit dhe në jetën publike...”

Raporti përfundimtar i projektit "Rinia për qeverisjen vendore", zbatuar nga Strehëza për Gratë dhe Vajzat e Dhunuara

c. Qasja ndaj komunikimit

LA ka një qasje të dyfishtë të komunikimit strategjik: së pari, promovon intensivisht rezultatet dhe punën e grantmarrësve të mbështetur nga LA dhe, së dyti, sjell çështjen e demokracisë vendore në axhendën kombëtare. Në këtë drejtim ka pasur rezultate thelbësore:

- 25 lajme të botuara në media lidhur me aktivitetet e LA ose të grantmarrësve;
- 96 produkte multimediale/video nga grantmarrësit që ngrenë çështjen e demokracisë vendore;
- 12 artikuj investigativë për çështje të ndjeshme si zbatimi i ligjit të dekriminalizimit për kryetarët e bashkive dhe anëtarët e këshillave, ndërtimi i sheshit të lojërave në Liqenin e Tiranës, vrasja e një të riu në Sharrë etj.;
- 103 artikuj janë shkruar nga grantmarrës në mediat sociale dhe gazeta;
- 1 mini-dokumentar i prodhuar nga LA për të promovuar histori suksesi;
- 10 artikuj të botuar në gazetatat kombëtare që fokusohen në problematika si zbatimi i ligjit për të drejtën e informimit në nivel vendor, roli i shoqërisë civile si katalizator në nivel vendor;
- 10 aktivitete që promovojnë nismat e LA për përmirësimin e demokracisë vendore dhe shkëmbimin e përvojave;
- Fushatë agresive në profilet e Medias Sociale të projektit; 14 mijë ndjekës në Facebook në 1 vit e gjysmë;
- Çdo aktivitet vendor i organizuar nga projekti ka pasur vizibilitet në mediat lokale, me qëllim përhapjen e mundësisë për të aplikuar në thirrjet për aplikime dhe Instrumentin e Reagimit të Shpejtë;
- 13 pjesëmarrje në programe televizive për promovimin e LA dhe grantmarrësve.

Më 24-28 Prill 2017, LA organizoi Javën "Lëviz për Demokraci", që u ideua si një javë e mbushur me aktivitete kushtuar demokracisë vendore. 10 aktivitete në Shkodër, Pukë, Elbasan dhe Tiranë u organizuan nga LA për

çështjet e demokracisë vendore, të evidentuara kryesisht nga grantmarrësit. Aktivitetet gjeneruan diskutime publike mbi problematika të prekshme të demokracisë vendore si transparenca, llogaridhënia dhe pjesëmarrja aktive në vendimmarrje. Kjo javë ndihmoi për shkëmbimin e përvojave të mira mes grantmarrësve në lokalitete të tjera, si teatri i luajtur nga "FemArt" i grupimit "ATA" në Shkodër, ose shembulli i mirë i Bordit Rinor të Vorës që u prezantua në Pukë etj. Një forum kombëtar u organizua për të debatuar mbi rolin vendimtar që kanë transparenca e financave vendore dhe anëtarët e Këshillave Bashkiakë në demokracinë vendore. Më shumë se 850 persona morën pjesë në aktivitetet e organizuara nga LA gjatë kësaj jave.

Kapitulli 4: Financat dhe menaxhimi

Buxheti i miratuar për LA për vitin e dytë të projektit (1 Korrik 2016 - 30 Qershor 2017) ishte 1,861,920 CHF. Gjatë periudhës së raportimit, LA finalizoi procesin e dhënies së granteve për Thirrjet nr. 2 dhe nr. 3 për Aplikime. Konkretisht, LA kontraktoi:

- 19 kontrata granti nën Thirrjen nr. 2 për Aplikime me buxhet total 383 000 CHF:
 - 13 grante iu dhanë OJF-ve;
 - 6 individëve.
- 33 kontrata granti nën Thirrjen nr. 3 për Aplikime me buxhet total 738 947 CHF:
 - 24 grante iu dhanë OJF-ve.
 - 9 individëve.
- 3 grante të Reagimit të Shpejtë me buxhet total 34 630 CHF.

GRANTET E DHËNA




Tabela 1 më poshtë jep një përmbledhje për Vitin e dytë të Projektit, ndërsa Tabela 2 jep panoramën progresive për secilën thirrje për aplikime për të gjithë periudhën e zbatimit.

Tabela 1: Përmbledhje për Vitin 2

	Shuma e kontraktuar			Shuma e disbursuar		
	OJF	Individë	TOTAL	OJF	Individë	TOTAL
Grantet Thirrja 1	-	-	-	124,840	56,829	181,670
Grantet Thirrja 2	319,000	64,000	383,000	251,074	39,480	290,554
Grantet Thirrja 3	646,023	92,924	738,947	346,286	1,427	347,713
Reagimi i Shpejtë	34,630	-	34,630	34,138	-	34,138
Total	999,653	156,924	1,156,577	756,338	97,737	854,075

CHF

Tabela 2: Përmbledhje progresive, Viti 1+Viti 2

CHF

	Shuma e kontraktuar			Shuma e disbursuar		
	OJF	Individuals	TOTAL	OJF	Individuals	TOTAL
Grantet Thirrja 1	361,848	63,038	424,886	337,854	58,800	396,654
Grantet Thirrja 2	319,000	64,000	383,000	251,074	39,480	290,554
Grantet Thirrja 3	646,023	92,924	738,947	346,286	1,427	347,713
Reagimi i Shpejtë	48,881	-	48,881	46,964	-	46,964
Total	1,375,752	219,962	1,595,714	982,178	99,707	1,081,885

LA u jep mbështetje të vazhdueshme dhe këshillim grantmarrësve të kontraktuar për të rritur kapacitetet e tyre dhe për të garantuar menaxhimin dhe zbatimin efektiv të projekteve.

Kapitulli 5: Vazhdimësia

Sfidat kryesore në vitet në vijim lidhen me zbatimin e rekomandimeve nga Rishikimi i Brendshëm Afatmesëm (RBA). Shtyllat kryesore të projektit për këtë vit janë:

- Përmirësimi i mekanizmit të granteve me bazë kërkese, për të siguruar shtrirjen deri te aktorët e shoqërisë civile me bazë në komunitet. LA do të prezantojë një qasje grantesh të dyfishtë në dy thirrjet për aplikime, për të stimuluar organizatat e vogla me bazë në komunitet që të aplikojnë. Gjithashtu, LA ka zgjeruar drejtimet e thirrjeve në fushat e veta klasike, duke i dhënë mundësi më shumë grupeve si artistet, sportistët, të rinjtë, etj. që të bëhen pjesë e thirrjeve për aplikime;
- Ndërtimi i praktikave/projekteve të suksesshme të granteve të mbështetura nga LA përmes mekanizmit të vijueshmërisë. Një thirrje e hapur për grantmarrësit e LA do të shpallet bashkë me Thirrjen nr. 4 për Aplikime, ku do të ftohen grantmarrësit e mëparshëm që të vijnë projektet e tyre;
- Rritja e mëtejshme e vizibilitetit të rezultateve nga projektet dhe krijimi i sinergjive mes grantmarrësve nëpërmjet shkëmbimit të mësimave të nxjerra dhe aktiviteteve mes homologësh (*peer to peer*);
- Rritja e komponentit të forcimit të kapaciteteve përmes sesioneve të trajnimit në terren dhe *online*, si edhe këshillimi nga afër i grantmarrësve;
- Përmirësimi i platformës së hapur financiare për të dhënat bashkiake duke e bërë platformë praktike në përdorim dhe lehtësisht të kuptueshme për kategori të ndryshme;
- Mbështetje për mediat dhe aktivistët vendorë që të jenë aktivë në komunitetet e tyre për forcimin e demokracisë vendore;
- Ofrimi i mbështetjes ligjore për aktivistët vendorë për çështjet që lidhen me demokracinë vendore.